



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**Anr.860/2021**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Ferki Xhaferi kryesues, Rustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Ferizajt Shqipe Jashari nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Ferizajt, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.11.2021, mori këtë:

### **V E N D I M**

Refuzohet i pa bazuar apeli Anr.860/2021 i datës 04.11.2021, i kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Ferizajt, Shqipe Jashari nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Ferizajt, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, lidhur me vendvotimet 2504D/05D, 2509D/02, 2520D/02D, 2529D/02R, 2503D/02R, 2532D/02D, 2528D/02R.

### **A r s y e t i m**

PZAP-i, me datë 04.11.2021, ka pranuar apelin Anr.860/2021, i ushtruar nga Shqipe Jashari, Kandidat për Kuvend Komunal nga Lëvizja Vetëvendosje, me të cilën pretendon se në qendrën e votimit me nr. 2529D/02R, kam pasur gjithsej 10 votues ndërsa nga rezultatet e marra nuk figurojnë asnjë votë. Ndërsa në formularin e kutisë së vendvotimit 2503D/02R, është fshirë numri i votave duke bërë të pamundurën të vërtetohet numri i tyre. Në qendrën e votimit 2532D/02D, dyshojmë se mungojnë disa vota pasi që dëshmitarët kanë dëshmuar se kanë votuar më shumë se sa rezultati i paraqitur. Në qendrën e votimit nr 2528D/02R, kam pasur afro 15 hetues, ndërsa nga rezultati figurojnë vetëm 4 vota. Kërkojë që për këtë vendvotime të bëhet rinumërim.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Apeli është i pa bazuar**

Nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se apeli i parashtruar nga Shqipe Jashari nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, me të cilën kërkon rinumërim të votave në

vendvotimet 2504D/05D, 2509D/02, 2520D/02D, 2529D/02R, 2503D/02R, 2532D/02D, 2528D/02R, është i pa bazuar.

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tije, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara siç pretendon në apelin e paraqitur, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, e në rastin konkret, paneli gjeti se pretendimet e apeluesit nuk janë mbështetur në prova dhe fakte konkret por janë vetëm pretendime të supozuara dhe se këto pretendime për Panelin nuk janë të pranueshme. Paneli i shqyrtoi pretendimet e palës ankuese për parregullsi në vendvotimet 2529D/02R, 2503D/02R, 2532D/02D, 2528D/02R, mirëpo për të njëjtat vendvotime nuk ka ofruar asnjë dëshmi qoftë formular, apo deklaratë që do të vërtetonte pretendimet ankimore.

Ndërsa lidhur me vendvotimet 2504D/05D, 2509D/02, 2520D/02D, paneli pas shqyrtimit të tyre dhe verifikimit, gjeti se për të njëjtat vendvotime, KQZ-ja veç se ka marrë vendim për rinumërim para se rezultati përfundimtar të publikohet andaj të njëjtat janë të rinumëruara, për këto arsye paneli vlerëson se një rinumërim tjetër për të njëjtat vendvotime të rinumëruara nga KQZ-ja në QNR, është i pa arsyeshëm, për më tepër ankuesi nuk ka ofruar prova shkresore që do ta argumenton se parregullsitë kanë ndodhur me rastin e rinumërimit andaj si të tilla këto pretendime janë të paqëndrueshme.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidatin.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Anr.860/2021 më datën 06.11.2021**

**Kryesues i Panelit  
Ferki Xhaferi**

***Këshilla Juridike:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.